




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No 01-2588/14
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 11-07-2014
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10) dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.07.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2023-14 për z. *Qamil Kolloni – Ish Këshilltar Komunal në Komunën e Dragashit, për shkak se i njejtë, tashmë, ka mbaruar mandatin e Këshilltarit Komunal dhe ndërkohë nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik, prandaj nuk ka konflikt interesi.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2023-14, për ish zyrtarin e lartë, z. Qamil Kolloni – ish Këshilltar Komunal në Komunën e Dragashit dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Ish zyrtari i lartë, z. Qamil Kolloni fillimisht i është bërë një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Kolloni ka sqaruar se ai tashmë nuk është zyrtar i lartë për shkak se i ka mbaruar funksioni i tij publik si Këshilltar Komunal në Komunën e Dragashit, dhe me tutje nuk ka marr asnjë funksion tjetër si Zyrtar i lartë.

Këtë e kemi konfirmuar me Formularin për Deklarimin e Pasurisë (pas mbarimit të funksionit), të cilin ztr. Kolloni e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (D.P.03-1625-14).

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori Agjencisë kundër Korrupsionit

